



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E MBROJTJES , PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

PROJEKT-VENDIM

Nr. 06 datë 19.03.2025

“Për miratimin e ndryshimit të VKB NR.33 dt.28.04.2023 dhe VKB NR 80 dt.30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit”

Në mbështetje të nenit 24, pika 2, neni 54 gërma “ n” e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ; Ligji nr 22/2018 “ Për strehimin social” i ndryshuar, neni 2 pika 51; VKM nr 384, datë 12.06.2019 “ Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, me propozimin e Sektorit të Strehimit Social, Kryetar i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të :

VENDOSI

1. Ndryshimin e VKB NR.33 dt.28.04.2023 dhe VKB NR.80 dt.30.10.2023.
2. Miratimin e ngritjes së komisionit të strehimit, me përbërje si më poshtë:
 - Dajana Lleshi – Kryetar, Drejtorja e Mrojtjes Përfshirjes dhe Strehimit Social
 - Silvana Ismailaj - Zv/ Kryetar, Sektori i Asistencës Ligjore, Kontratave dhe çështjeve gjyqësore.
 - Marian Marku – Anëtar, Sektori i Buxhetit dhe Financës
 - Indrit Kurtbegu -Anëtar, Sektori i Investimeve.
 - Aurela Deda - Anëtar, Drejtorja e Mrojtjes Përfshirjes dhe Strehimit Social
 - Suela Domnori- Anëtar, Përfaqësuese e Organizatës “Gruaja te Gruaja” Shkodër
 - Kujtime Nurja-Anëtar, Përfaqësuese e Organizatës Qendra e Gruas “ Hapat e Lehtë”.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”)

KRYETARI
Kristian Shkreli

Në mungesë dhe me urdhër

ZV/KRYETARI
Aleksandra Gjoni



Konceptoi: E.Gjeçaj
Pranoi: D.Lleshi
Miratoi: R.Luzaku
Konfirmoi Bazen Ligjore: E.Preka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MBROJTJES , PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

Nr. — prot.

Vau Dejës, me 19/03 /2025

RELACION

Në mbështetje të nenit 24, pika 2, neni 54 gërma “ n” e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ;në zbatim të ligjit nr 22/2018 “ Për strehimin social”i ndryshuar; VKM nr 384, datë 12.06.2019 “ Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, u krye ndryshimi i pjestarëve të Komisionit të Strehimit për shkak të largimit të disa anëtarve nga detyrat funksionale në institucionet përkatëse.

Qëllimi është krijimi i një kuadri rregullator për mënyrën e përbërjes dhe funksionimit të Komisionit të Strehimit, për një veprimtari më eficiente dhe transparente ndaj të tretëve, të përcaktuar nga aktet ligjore dhe nënligjore të Republikës së Shqipërisë. Ky Komision në përputhje me normat juridike, duhet që, sa herë në Bashkinë Vau Dejës ka në zbatim një program social strehimi, të shqyrtojë kërkesat dhe dokumentacionin për të bërë të mundur, vlerësimin teknik sipas sistemit të pikëzimit të miratuar në Këshillin Bashkiak, të listës emërore të personave aplikues, me qëllim sigurimin e transparencës dhe efijencës së tij si organ kolegjal përballë aplikuesve.

Në ushtrimin e funksioneve të tij, Komisioni i Strehimit trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha dosjet e aplikantëve në programet e strehimit social.

Konceptoi: **E.Gjeçaj**